



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-8764/1 të datës 17.10.2022, **NDËRPRITET.**

Lënda nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent.

Lënda me numër 12-8764 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-8764/1 datë 17.10.2022 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur. Denoncimi u plotësua radhazi më 31.10.2022. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për punë të pakujdesshme dhe keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar nga drejtori i ///, person zyrtar ///, drejtor. Pretendimet janë bërë për shkelje të rendit dhe disiplinës së punës nga ana e punonjësve, mosmarrje masash për veprime të tilla, tolerim i sjelljeve joprofesionale të punonjësve (ardhje në punë në gjendje të dehur), punësime dhe avancime të paligjshme, si dhe keqpërdorim të automjeteve zyrtare. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë paraqitur edhe prova.

Lënda me numër 12-8930/1 të datës 25.10.2022 është themeluar në bazë të denoncimit të parashtruar nga një parashtrues i panjohur, i cili fillimisht i është dorëzuar Avokatit të Popullit të RMV-së në Shkup dhe prej andej i është përcjellë KSHPK-së për veprime kompetente. Bëhet fjalë për të njëjtin rast, të përshkruar më sipër. Në shtojcë janë bashkangjitur edhe prova.

Për hir të trajtimit të duhur të pretendimeve, KSHPK-ja i bashkoi dy lëndët e lartpërmendura në një dhe e zhvilloi procedurën me një numër të vetëm arkivor 12-8764/1 nga 17.10.2022.

Duke vepruar sipas lëndës, KSHPK-ja kërkoi shqyrtimin e pretendimeve nga Inspektorati Shtetëror Administrativ i RMV-së, nga Inspektorati Shtetëror i Punës i RMV-së dhe një auditim të brendshëm në subjektin e lartpërmendur. Inspektorati Shtetëror i Punës ka marrë njoftim se pretendimet për shkelje të legjislacionit të punës janë të pabazuara. Në lidhje me abuzimin me automjetet zyrtare, KSHPK-ja ka marrë njoftim se auditori i brendshëm është larguar nga puna në ///, kështu që këto pretendime nuk mund të hetohen. Rrjedhimisht, KSHPK-ja ka kërkuar veprim kompetent nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, nga ku ka marrë përgjigje se pretendimet në fjalë janë dorëzuar për veprim kompetent në Departamentin për Inspektim Financiar në Sektorin Publik pranë Ministrisë së Financave të RMV-së. Duke vlerësuar kompetencat e këtij sektori, KSHPK-ja vlerëson se nuk ka përgjegjësi të veprojë në lidhje me pretendimet nga denoncimi që kanë të bëjnë me dyshimet për keqpërdorim të automjeteve zyrtare. Duke vepruar në këtë mënyrë, KSHPK-ja ka shteruar të gjitha kompetencat e saj ligjore për të shqyrtuar pretendimet përkatëse për këtë çështje.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:  
- Arkivi i RMV-së

Përgatiti: Mr. D.D  
Miratoi: Mr. SH.S

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
NËNKRYETAR,  
Katica Nikolovska**